



FOTO: ME4EU – STANI I VUJOS - DITA E BASHKËPUNIMIT EVROPIAN - 2021

# PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit  
ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe  
Mal i Zi - Kosovë 2014- 2020

## Dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

Edicioni i dymbëdhjetë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë\* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

### Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

### Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

- » Dita e Bashkëpunimit Evropian – 2021 .....2
- » Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri..... 3
- » Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë .....4
- » Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri .....5
- » Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë ..... 7
- » Team building për strukturat e programeve.....9

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

Башкимит Европийн 9-р жилийн өмнөхөөр төлөөлөгчид

\*Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt është i financuar  
nga Bashkimi Evropian



**MNE - ALB**  
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020



**MNE - KOS**  
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020

# CBC ZOOM

## Dita e Bashkëpunimit Evropian - 2021

Me rastin e Ditës së bashkëpunimit Evropian 2021, u organizua me datë 24 shtator të vitit 2021 eventi "Rezultatet dhe vlerat e bashkëpunimit Evropian prezantohen për Ambasadorët e BE në Malin e Zi", gjatë të cilit u prezantuan rezultatet e të gjithë projekteve të financuara dhe zbatuara në kuadër të të dy programet në këtë rajon.

Dita e Bashkëpunimit Evropian u organizua në formën e një vizite në stanin e Vujos, që është përmirësuar nga ndërhyrja e projektit "Turizmi Rural për Zhvillimin Ekonomik të zonës kufitare", zbatuar në programin paraardhës Mal i Zi- Kosovë, dhe një shëtitje të shkurtër në shtigjet e malit Çakor. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm përfaqësues nga zyra e NIPAC, zyra e Integritimit Evropian, Delegacioni i BE në Malin e Zi, ambasadorët e vendeve të BE dhe vendeve pjesëmarrëse në program, SPT, struktura operuese e Kosovës, përfituesit e projekteve, përfaqësues të organizatave që kanë zbatuar projektet dhe përfitues të programit.



Qëllimi i aktivitetit ishte promovimi i projekteve që janë duke u zbatuar në kuadër të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi – Kosovë, të fokusuar në territorin e komunave Berane, Plavë, Petnicë, dhe Guci. Ky event ishte gjithashtu edhe një mundësi për të diskutuar rezultatet që vendet kanë arritur nga programet ndërkufitare dhe programet e bashkëpunimit transnacional.



Koordinatorja kombëtare IPA dhe drejtuesja e negociatave, **Zorka Kordiq**, gjatë vizitës në stanin e Vujos, në Çakor, i falenderoi pjesëmarrësit që ishin bashkuar në festimin e Ditës së Bashkëpunimit Evropian dhe nënvizoi që, këto aktivitete dëshmojnë që rezultatet janë të prekshme edhe në zonat e thella rurale, që do të thotë se, bashkëpunimi ndërkufitarë mundëson valorizimin e plotë të potencialeve tona të trashigimisë natyrore.



**Jelena Krivčević** nga Agjencia e Zhvillimit Rajonal Bjelasica, Komovi dhe Bjeshkët e Nemuna, si përfitues që ka zbatuar projekte nga të dy programet, bëri një përshkrim të zonës dhe rezultateve të arritura nga zbatimi i projektit "Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës" dhe "Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike" nga thirrja e I-rë e programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë që, në sinergji me njëri-tjetrin, kanë krijuar ofertën turistike dhe shtegun "Bjeshkët e Nemuna".

## Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

### Prodhimi i mjedrave vazhdon

Familja Ramdedoviq, si përfitues final i projektit "Të rinjtë malazez dhe shqipëtarë për kulturën e lule mjedres" po marrin frutet e punës së tyre, të arritura nga zbatimi i projektit. Në një intervistë të dhënë kohët e fundit në një TV lokale, **Samir Ramdedoviq**, tha se ata kishin marrë një mbështetje të konsiderueshme nëpërmjet të mbjellave dhe pajisjeve, por edhe nga procesi i mentorimit. Ai shtoi se, ishte shumë i lumtur me rezultatet e këtij viti, dhe deklaroi se kishte arritur të shiste të gjithë prodhimin e mjedrave në vitin 2021 me një çmim prej 3,30 EUR për kilogram.



Shikoni videon [këtu](#).

### U mbajt konferenca përmbyllëse e projektit "Rritja e Bashkëpunimit"

Me 9 dhjetor të vitit 2021, Muzeu i Polimjess mikëpriti konferencën përmbyllëse të projektit "Rritja e bashkëpunimit – Nga antikitetet Kristiane drejt përmirësimit të Turizmit". Qëllimi i projektit ishte të kontribuojë në zhvillimin e turizmit nëpërmjet promovimit dhe valorizimit të përbashkët të trashigimisë arkeologjike dhe kulturore të zonës kufitare, ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë.



Drejtesja e Muzeut të Polimjes **Violeta Foliq** deklaroi se, rezultatet e arritura janë përtej pritshmërive të tyre. Ajo theksoi se, vendi i gërmimeve është shumë i veçantë dhe që, në Berane u zbulua një Bazilikë me aneks, si dhe një ndërtesë ndihmëse me dy mure. Ajo falenderoi **Konstantin Dojiq** nga dioqezja e Budimlsec dhe Nikshiqit,



partnerët nga Shqipëria, banorët e fshatit Rzanica dhe komunes së Beranes për bashkpunimin e tyre të rëndësishëm në projekt.

Nënkryetari i komunes së Beranes, **Darko Stojanoviq**, falenderoi partnerët e projektit për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve. Ai shtoi se, bashkëpunimi me partnerët shqipëtarë është në nivel të lartë dhe se ai pret që, nga të tillë projekte të shtohen përfitimet e qytetarëve dhe të sektorit të kulturës.

Z. **Dojiq** theksoi rëndësinë e programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë dhe se ky ishte projekti i katërt që Dioqezja e Budimlsec dhe Nikshiqit po zbatonte. Ai shtoi se, me Muzeun e Polimjes kanë një bashkpunim të gjërë dhe se rezultatet e projektit janë të jashtëzakonshme.



**Holta Koçi**, nga organizata *Albania Community Assist*, falenderoi kolegët e saj nga Muzeu i Polimjes për mikëpritjen dhe bashkëpunimin dhe deklaroi se, gjatë zbatimit të projektit ka patur edhe sfida që u tejkaluan nga bashkëpunimi i ngushtë, duke mundur kështu përfundimin e të gjithë aktiviteteve. Ajo shtoi se, bashkpunimi ndërmjet partnerëve do të vazhdojë dhe se shpreson që të zhvillohen më shumë projekte për shkëmbimet studentore.

Pjesëmarrësit u përshëndetën edhe nga **Predrag Lutovac**, arkeolog tek Muzeu i Polimjes. Ai tha se, Muzeu i Polimjes ishte i pari që regjistronte të gjitha sitet arkeologjike, dhe në bazë të përmbajtjes, kanë zgjedhur lokacionin për gërmime, duke mundur plotësimin e koleksionit në muze. Ai gjithashtu shtoi se, ky do jetë një bashkëpunim afatgjatë që nuk do ndërpritet, por do vazhdojë në kohë me aktivitete të ndryshme, me dëshirën për të vazhduar shkëmbimet me miqtë shqipëtarë dhe për të vizituar përsëri rajonin e Shkodrës dhe anasjelltas.

Gjatë projektit, dy site arkeologjike në Mal të Zi dhe Shqipëri, Tumarice Kastrom afër Beranes dhe Bazilika Kristiane Hot në Kastrat, u gërmuan, ruajtën, mbrojtën, promovuan dhe pajisen me sinjalistikë dhe u integruan në ofertat turistike lokale.



Gjithashtu, në mënyrë që të prezantohen rezultatet e projektit në Hot të Malësisë së Madhe, me 28 tetor të vitit 2021 u mbajt një konferencë për shtyp me fokus rritjen e bashkëpunimit ndërkufitarë mbi antikitetet kristiane dhe zgjerimin e turizmit. Lokacioni që ishte pjesë e këtij projekti u vizitua edhe nga studentët e arkeologjisë nga Mali i Zi dhe Shqipëria.

Rezultatet e projektit dhe bashkëpunimi ndërmjet aktorëve u prezantua nga Kosta Dojiq, nga Dioqeza e Budimles dhe Nikshiqit nga Mali i Zi, nga përfqasuesi në projekt i palës shqipëtare, Ormir Shqarri dhe zëvendës kryetari i bashkisë Malësi e Madhe, Sytki Ndreca.


Shikoni videon nga aktiviteti [këtu](#).



Hot, Malësi e Madhe : Konferencë për Shtyp : " Rritja e Bashkëpunimit-aktivitetet e krishtera në funksion të zhvillimit të turizmit".

### FAKTE - 500 vjet në 3D

Si rezultat final i projektit "Rritja e Bashkëpunimit – nga antikitetet kristiane drejt forcimit të turizmit" u krijua një aplikacion Android që mundëson të shihet si kanë qënë fortifikimet rreth viteve 500, në paraqitje tre-dimensionale. Aplikacioni mund të shkarkohet [këtu](#) dhe përdoret si guide gjatë vizitës në vend.



**Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë**

### Eko-turizmi dhe turizmi aktiv

Projekti *Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike* ka përmbyllur aktivitetet me organizimin e konferencës përfundimtare të mbajtur në Podgoricë gjatë së cilës janë prezentuar rezultatet e arritura brenda projektit. Projekti rezultoi në përmirësimin e infrastrukturës së turizmit në natyrë dhe rritjen e sigurisë për turistët, si dhe krijimin dhe promovimin e ofertës ndërkufitare dhe shtigjeve të reja turistike.

Qendra e Shpëtimit në Luginën e Grebajës është rinovuar, adaptuar dhe pajisur me pajisje teknike, mjekësore, personale, sistem radio komunikimi dhe dron me kamera termike. Përveç kësaj, për shpëtuesit malor janë ofruar kurse trajnimi me temë intervenimin dhe shpëtimi në periudhen dimërore dhe verore. Si rezultat kyç, pas zbatimit të projektit, për herë të parë në Kosovë u themelua Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit Malor i Kosovës.

Paketa turistike Accursed Mountain experience (Përjetimi i Bjeshkëve të Nemuna) "Itineraret - si të kaloni 7, 4 ose 1 ditë në Bjeshët e Nemuna" është promovuar gjatë zbatimit të projektit Faqja e internetit (për aplikacione iOS dhe Android) <http://accursed-mountains.me/> paraqet një nisëm të përbashkët të dy projekteve ndërkufitare – projekti *Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike* dhe projekti *Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës*. Po ashtu, 68 km të shtigjeve janë rinovuar, janë më të sigurtë për turistët dhe janë dixhitalizuar.

Shtigjeve të dixhitalizuara mund t'i qaseni [këtu](#).



*bimëve aromatike dhe medicinale për përmirësimin e jetesës dhe ruajtjen e biodiversitetit*".



Konkretisht, me këtë projekt, popullsia e bashkisë së Tropojës dhe komunes së Plavës do trajnohen për llojet e bimëve medicinale dhe aromatike të zonës, mënyrat më të mira për mbledhjen e tyre, kurse administrata e institucioneve vendore do të rrisë kapacitetet për monitorimin më rigoroz të këtyre bimëve në territoret respektive.

Herbariumi do mbahet brenda koleksionit të Luleve dhe Fiereve, dhe do promovohet në ekspozitat pasardhëse të muzeut.

Projekti "Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të bimëve aromatike dhe medicinale për përmirësimin e jetesës dhe ruajtjen e biodiversitetit" po zbatohet nga komuna e Plavës, bashkia Tropojë, OJQ Qendra për Zhvillim dhe Integrim Demokratik dhe OJQ Alpet Shqipëtare.

#### FAKTE - Paketa turistike Accursed Mountain experience

##### Si të kaloni 7 në Bjeshët e Nemuna :

**Dita I:** Mbërritja në Plavë, Vizitë në Kulla Rexhepagiq, Shëtitje rreth liqenit të Plavës, Darkë tradicionale në amvisërinë rurale Saviq.

**Dita II:** Vizitë në Kopshtin Botanik Velemun, shëtitje nëpër majet e akullnajës së Bjeshkëve të Nemuna, Kalimi i një nate (fjetje) në katun .

**Dita III:** Shëtitje e mëngjesit përgjat liqenit të Hridit, Vizitë burimeve të Ali Pashës .

**Dita IV:** Mbërritja në Luginën e Grebajës, Shëtitje rreth bukurive natyrore të luginës.

**Dita V:** Nisja për Kosovë (rekomandohet nepërmjet Hajlles), Vizitë Manastirit të Decanit, Dreka në kullë në Drenoc. .

**Dita VI:** Eksplorimi i maleve rreth Deçanit.

**Dita VII:** Vizita e atraksioneve kryesore të Pejës, Nisja për në Gjakovë, Shëtitje nëpër qytetin e vjetër të Gjakovës.

Për më shumë informacion klikoni [këtu](#).

#### Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

##### Herbarium për bimët medicinale dhe aromatike i Bjeshkëve të Nemuna i dhurohet Muzeut Historik Natyrorë

Me 28 tetor të vitit 2021, përfaqësuesit e komunes së Plavës i dhuruan një herbarium me bimë medicinale dhe aromatike muzeut Historik Natyrorë të Malit të Zi.

Bimët e këtij herbariumi u mbledhën gjatë zbatimit të projektit të financuar nga fondet e BE, "Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të

#### Liqeni i Shkodrës pa ndotje Kimike - Solution

Projekti *Liqeni i Shkodrës pa ndotje Kimike – Solution*, po zbatohet nga Qendra për kërkime toksikologjike Mal i Zi, Universiteti i Tiranës, Shqipëri dhe Asocioni Green Centre, Shqipëri. Projekti synon të arrijë dakortësimin mbi aktivitetet e bashkëpunimit të përbashkët afatgjatë, të bëjë vlerësimin e riskut mbi mjedisin lidhur me ndotjen kimike në liqenin e Shkodrës dhe të identifikojë pikat e nehta të ndotjes ("hot spotet").

Si pjesë e aktiviteteve të tyre, projekti filloi me aktivitetin hulumtues në Liqenin e Shkodrës, në tetor të vitit 2021. Konkretisht, ekipi i projektit është duke punuar me vlerësimin e riskut mjedisorë lidhur me ndotjen kimike në liqen.

#### FAKTE - Solution

Ekipi i projektit është duke bërë promovim të mirë të projektit dhe rezultateve që synojnë të arrijnë. Si pjesë e aktiviteteve, është krijuar një web faqe me informacionet kryesore dhe mund të aksesohet tek <http://solutionmne-al.eu/>



## U organizua Forumi ndër-kufitarë për bashkëpunim në të ardhmen

Me 16 nëntor të vitit 2021, u organizua Forumi ndër-kufitarë për bashkëpunim në të ardhmen, në kuadër të projektit Work4Youth. Eventi shërbeu për rritjen e kohezionit, shkëmbimeve, rrjetëzimit dhe partneritetit ndërmjet të rinjve nga Podgorica, Tivari, Tuzi dhe rajoni i Shkodrës. Kjo u arrit nëpërmjet aktiviteteve të rrjetëzimit, punës me grupe të vogla, mendimeve nga ekspertët shoqëruar me sugjerime për përmirësimin e mëtejshëm të ideve të tyre, mështetjes me kredi, financimeve të shumta në numër me sasi të vogla dhe platformave të ndryshme.



Partnerët e projektit deklaruan se, ndërveprimi mes të rinjve u rrit dhe kjo solli krijimin e kontakteve të reja për partneritete të mundshme, për zhvillimin e ideve të tyre në biznes, me ndikim zhvillimin socio-ekonomik të zonës ndër-kufitare.



## A.C.C.E.N.T.- Aksesi, Ndërgjegjja Qytetare, Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, si një Trend i ri

Projekti "A.C.C.E.N.T.- Aksesi, Ndërgjegjja Qytetare, Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, si një Trend i ri" po zbatohet nga organizata Caritas e Kryepeshkopatës së Tivarit (Mal i Zi), Caritas Shqipëri, OJF Projekti Shpresë (Shqipëri) dhe Asociacioni i Paraplegjikëve Tivar. Gjatë tre-mujorit të fundit të vitit 2021, partnerët e projektit kanë qënë aktiv në promovimin e projektit dhe publikimin e një sërë thirrjesh për shprehjen e interesimit për trajnerë dhe punësimin në aktivitetet e rritjes së kapaciteteve, mbështetjes dhe mentorimit të personave me aftësi të kufizuara.



## Zero mbetje Guci

Projekti "Mali i Zi dhe Shqipëria drejt Zero Mbetjeve" po zbatohet nga Agjencia e zhvillimit rajonal Bjelasica, Komovi and Prokletije, OJQ Zero Mbetje nga Mali i Zi dhe Fondacioni Shqipëtarë për zhvillimin e kapaciteteve lokale. Projekti synon të krijojë një platformë për drejtimin e komuniteteve lokale drejt qendrave me Zero Mbetje, të inkurajojë komunitetet lokale dhe mbështesë ato për të reduktuar, ricikluar dhe ripërdorur mbetjet dhe sigurimin e mbështetjes për praktikën e Zero Mbetjeve. Në kuadër të aktiviteteve të tyre, OJF Zero Mbetje Mal i Zi ka përfshirë, për herë të parë, informacion mbi Gucinë si pjesë e programit për qytetet me zero mbetje. Lexoni më shumë mbi Zero Mbetje Evropë - [The State of Zero Waste Municipalities Report 2021](#) ose shikoni ekstraktin nga raporti [këtu](#).



## Rrugët drejt zhvillimit të karrierës (RZK): Përgatitja e të rinjve shqiptarë dhe malazez për mundësitë e karrierës në sektorin e turizmit

Gjatë gjithë aktiviteteve të tyre, ekipi i projektit "Rrugët drejt zhvillimit të karrierës" ka përfshirë të rinjtë në punëtori të ndryshme me focus rritjen e kapaciteteve. Konkretisht, idetë e punësimit, sipërmarrjes dhe shkëmbimit të eksperiencave për rritjen e bashkëpunimit kanë qënë pjesë e këtyre diskutimeve nga 50 nxënës të shkollave profesionale nga Shkodra dhe Ulqini. Shikoni videon promovionale [këtu](#).



## Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

### Krijimi i vendeve të punës në bujqësi

Kryeqyteti i Podgoricës dhe Iniciativa për Zhvillimin e Bujqesisë së Kosovës – IADK janë duke zbatuar projektin *Krijimi i vende të punës në bujqësi*. Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2021, partnerët e projektit kanë mbështetur fermerët me trajnime, mentorim dhe grante, si dhe është hapur mundësia për punë praktike për të rininë/studentët në Kosovë. Shikoni videon promovuese [këtu](#).



Gjatë kësaj periudhe, me qëllim të lehtësimit të lidhjeve me blerësit e produkteve bujqësore (bimëve mjekësore aromatike) dhe përfituesve të projektit si prodhues të këtyre produkteve, IADK ka ndihmuar nënshkrimin e kontratave pesë vjeçare për plasim të produkteve me 20 përfituesit e projektit.



Gjithashtu, 20 studentë patën mundësinë të kryenë punën praktike në kompanitë që merren me bimë aromatike dhe mjekësore dhe në këtë drejtim të ngrisin kapacitetet e tyre profesionale dhe të gjejnë punësim.

### Transhumance - ofertë e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi

Ky projekt udhëhiqet nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqesisë së Kosovës (IADK) në partneritet me Agjencinë për Zhvillim Rajonal për Bjelasicë, Komovi dhe Bjeshkët e Nemuna. Në kuadër të projektit, katunët dhe familjet që praktikojnë traditën e transhumancës janë mbështetur me panele për energji të rinovueshme përmes sistemeve diellore, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e turizmit rural në malet në zonën ndërkufitare. Përveç kësaj, në Kosovë, përfituesit e sistemit diellor tani janë trajnuar në ofrimin e shërbimeve të cilësisë më të lartë për turistët që vizitojnë katunet e tyre dhe malet mahnitëse të Pejës dhe Istogut.

Po ashtu, projekti i deritanishëm ka kontribuar në pasurimin e ofertës turistike të maleve të Istogut dhe Pejës, duke i mbështetur familjet katun me katër (4) kampe. Në malet e Istogut dhe të Pejës, vizitorët mund të ngrenë tentat e tyre dhe të ndezin zjarr në një nga katër kampet e ngritura, përkatësisht në malin e Corrovode, Mokna dhe Shoshan (komuna e Istogut), ose në malin e Milishec në komunën e Pejës. Gjithashtu, është përfunduar instalimi i tetë pikave të pushimit në malet përreth Istogut dhe Pejës.



Për më tepër, është përditësuar edhe ueb-portali për [turizmin e Katuneve](#), duke ofruar informacion të plotë mbi katunët dhe shtigjet e katuneve të zonave të synuara nga projekti.



### CARES 2 - Veprimet ndërkufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues 2

Pas përmbylljes së suksesshme të projektit CARES i cili është mbështetur në kuadër të Thirrjes së pare për dërgimin e projekt-propozimeve, partneret në projekt FORS nga Mali i Zi dhe ECMI nga Kosova kanë vazhduar përpjekjet e tyre dhe mbështetjen në rritjen e cilësisë, qasshmërisë dhe ndërgjegjësisimit në fushën e shëndetit riprodhues përmes projektit të ri CARES 2 – Veprimet ndërkufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues 2. Projekti parashikon prokurimin e pajisjeve mjekësore për spitalet dhe qendrat shëndetësore, ndërkohë që po

#### FAKTE - Rekomandime për parandalimin e kancerit të gjirit

- Pas moshës 20 vjeçare çdo grua duhet të bëjë vetëkontrolle të gjirit çdo muaj.
- Nga moshë 30 deri në 40 vjeç, kontrolli mjekësor klinik është i detyrueshëm një herë në vit.
- Me rekomandimin e mjekut bëni ekzaminimin me ultratinguj të gjirit
- Në moshën 40 vjeç e lart, mamografia është e detyrueshme çdo dy vjet.

vazhdojnë ekzaminimet parandaluese për kancerin e gjirit dhe kancerin e qafës së mitrës.

Projekti fokusohet tek të rinjtë dhe kështu 600 të rinj nga zona e programit do të informohen drejtpërdrejt mbi sjelljen e përgjegjshme në lidhje me shëndetin e tyre riprodhues përmes kampeve rinore. Përveç kësaj, projekti i ri parashikon hapjen e shkollës së shtatzënisë që do të krijohet si pilot iniciativë gjatë projektit, duke synuar të përfshijë rreth 2000 gra shtatzëna.

Partnerët e projektit e shënuan muajin tetor si muajin e luftës kundër kancerit të gjirit përmes publikimit të artikujve informues mbi kancerin e gjirit. Si një fushatë promovuese, u botuan artikuj të ndryshëm dhe u organizuan emisione radio-televizive, ndërsa partnerët e projektit përdorën broshurën dhe spotin televiziv të prodhuar në kuadër të projektit të mëparshëm CARES për të promovuar rëndësinë e ekzaminimeve parandaluese.

#### FAKTE - Rekomandime për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës

- Kontrollat e rregullta vjetore gjinekologjike Duhet të fillojnë jo më vonë se 3 vjet pas fillimit të marrëdhënieve seksuale.
- Kryeni një PAPA test dhe ekzaminim kolposkopik të paktën një herë në vit.
- Përdorni mbrojtje adekuate gjatë marrëdhënieve seksuale .
- Një grua nga mosha 25 deri në 69 vjeç duhet të bëjë një kontroll të rregullt gjinekologjike të paktën një herë në vit.

### Qendrat turistike për oferta më të mira turistike në zonat malore më pak të zhvilluara


Komuna e Andrijevicës, në bashkëpunim me Komunën e Deçanit dhe SHBA "Shkëlzen Haradinaj" nga Kosova, janë duke zbatuar projektin *Qendrat turistike për oferta më të mira turistike në zonat malore më pak të zhvilluara* i cili është i fokusuar në zhvillimin e turizmit rural që do të rezultojë në krijimin e dy qendrave turistike. Në të dy vendet, së bashku me krijimin e shtigjeve përgjatë katuneve që do të angazhojnë familjet rurale në ofrimin e shërbimeve turistike.

Partnerët e projektit janë duke punuar në mënyrë aktive në përshtatjen dhe ndërtimin e shtëpive malore në Krivi do (Mali i Zi) dhe Bjeshkët e Belegut (Kosovë). Punimet janë duke u kryer dhe pritet të ndërtohen dy shtëpi malore (nga një në secilin vend), të pajisura dhe plotësisht funksionale me planet e menaxhimit të hartuara deri në fund të projektit.



Përveç kësaj, partnerët e projektit janë duke punuar në mënyrë aktive në zhvillimin e rrjetit të shtigjeve për të lidhur dy qendrat me shtigje të tjera të rëndësishme në afërsi. Nga ana malazeze, ekipi rishikoi shtigjet ekzistuese për ecje dhe çiklizëm, por edhe ecje me këpucë bore dhe ski, si dhe shtigje tematike. Si rezultat, u zhvilluan 3 propozime për shtigje: 1

për shtëpitë (me të verdhë) 16.50 km e gjatë, 1 për çiklizëm (me të kuqe) 40 km e gjatë dhe 1 për ecje me këpucë bore dhe ski (blu) 26 km e gjatë.



Në anën e Kosovës, partnerët kanë shkuar në terrenin malor nëpër malet e Deçanit dhe kanë bërë matje me GPS, për planifikimin dhe sinjalizimin e shtigjeve të ecjes në të gjitha malet e Deçanit që lidhen me Shtëpinë e Alpinizmit në Beleg.

### PRAXIS

Konsorciumi i ekipit të projektit, i udhëhequr nga Caritas Kosova në bashkëpunim me Caritasin e Malit të Zi, QAKP Gjon Nikollë Kazazi – Gjakovë dhe Komunën e Beranës janë duke zbatuar projektin *PRAXIS* që synon të nxisë punësimin e të rinjve nga zonat e synuara në rajonin ndërkufitar dhe pritet të rezultojnë në rritje të kapaciteteve për punësim dhe mundësi punësimi për nxënësit, studentët dhe të rinjtë e papunësuar.



Gjatë kësaj periudhe, rreth 500 nxënës/studentë të rinj të papunë në Kosovë dhe Mal të Zi morën sesione të përbashketa të orientimit për karrierë, ndërsa 37 mentorë u trajnuan në të dy vendet. Gjithashtu, 10 trajnime për aftësitë e buta dhe 5 trajnime për teknikat e kërkimit të punës u mbajtën për mbi 350 studentë dhe të rinj të papunësuar. Gjithashtu, u organizua 1 panair punësimi në Gjakovë për të krijuar lidhje ndërmjet institucioneve të arsimit formal dhe joformal, punëdhënësve, të rinjve dhe familjeve të tyre, duke bashkuar 22 kompani dhe 300 individë.





Në fund të nëntorit të vitit 2021, ekipi i projektit PRAXIS, së bashku me stafin menaxhues të Zyrës së Punësimit në Gjakovë dhe QAKP "Gjon Nikollë Kazazi" në Gjakovë, organizuan vizita për gjetjen e vendeve të punës në Kompaninë Industriale "KoBa" në Gjakovë, Prodhimin e letrës dhe furnizimin me gastronomi Kompania "Eko Pak" në Klinë dhe Sh.PK "AULONA". Vizitat u përgatitën me kujdes bazuar në interesin e tre grupeve të të rinjve të papunësuar.

## Trashëgimia kulturore - Thesari i Rajonit Ndërkufitar

Komunat e binjakëzuara, komuna e Pejës dhe komuna e Gucisë, me forca të përbashkëta po zbatojnë projektin *Trashëgimia kulturore – Thesari i Rajonit Ndërkufitar*. Qëllimi i projektit është të kontribuojë në vlerësimin e trashëgimisë kulturore në rajonin e Beshkëve të Numuna duke krijuar rrugë dhe shtigje të reja kulturore si produkt dhe ofertë e re turistike në zonën e synuar.



Gjatë kësaj periudhe, ekipi i projektit kreu një sërë aktivitete për të ofruar informacion mbi asetet e trashëgimisë, vlerat përfaqësuese të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe vlerësimin e nevojave për pronarët e shtëpive të vjetra, familjet rurale përgjatë rrugëve kulturore dhe organizatat turistike.



Nëpërmjet projektit janë blerë aparate audio, të cilat do të përdoren për të prezantuar ofertën turistike të Gucisë përmes përmbajtjes audio të përgatitur dhe vizitorët do të zgjedhin pikat në rrugën kulturore sipas dëshirave dhe interesave të tyre. Përveç kësaj, u prokuruan guida turistike, qëllimi i të cilave është t'u mundësojnë guidave në një vend të caktuar turistik të punojnë më lehtë dhe më komod dhe t'u japin vizitorëve një dëgjueshmëri të mirë dhe një përvojë të plotë. Projekti gjithashtu ofroi një shfaqje interaktive që do të jetë në dispozicion për të gjithë turistët që vizitojnë Gucinë dhe do të përmbajë informacionin e nevojshëm për potencialin turistik të komunës dhe shërbimet. Si rezultat kyç, përmes projektit do të bëhet ngritja e një pike informacioni turistike, ku turistët do të mund të marrin të gjithë informacionin në lidhje me ofertën turistike të Gucisë. Punimet e ndërimit janë në zhvillim dhe

objekti do t'i kalojë për përdorim Organizatës Turistike pas përfundimit të punimeve.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve të objekteve të trashëgimisë përgjatë rrugës kulturore dhe ofrimit të shërbimeve më të mira për turistët, janë blerë edhe guidat audio në Pejë. Për më tepër, tabelat informuese janë vendosur në tri hyrje kryesore të Pejës për të shkëmbyer informacione në lidhje me asetet e trashëgimisë kulturore të qytetit, si dhe shenja sinjalizuese para aseteve të trashëgimisë në Pejë dhe karriget e pushimit.



Në Pejë është mbajtur trajnimi për ngritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin për trashëgiminë kulturore, vlerën, rëndësinë e ruajtjes dhe mënyrën e interpretimit të trashëgimisë kulturore. Turizmi kulturor, aktorët kryesorë në zinxhirin turistik dhe vlerat dhe standardet në rrugën kulturore ishin tre temat kryesore të diskutuara.

Gjithashtu, janë bërë studime në terren lidhur me ndërhyrjet në ndriçimin e Muzeut Etnologjik në Pejë si një pasuri e trashëgimisë materiale. Poashtu, është projektuar idea konceptuale e info kioskes së ardhshme për nevojat e organizatës turistike, si dhe dizajni i objektit i cili do të ndërtohe në Guci.

Ndiqni aktivitetet e projektit në faqen e dedikuar në [Facebook](#).

## "Team building" për strukturat e programeve

"Team building" u organizua më 7 dhe 8 dhjetor të vitit 2021 për strukturat operative të programeve. Qëllimi i evinimentit ishte diskutimi i përbashkët mbi arritjet e projekteve të financuara në kuadër të IPA Programeve të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi – Kosovë, si dhe asistencat teknike në kuadër të këtyre dy programeve. Gjithashtu, pati një diskutim të hapur për përgatitjen e skenës për IPA III dhe kapitalizimin e rezultateve të IPA programeve të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi – Kosovë. Në kuadër të aktivitetit u organizua një vizitë në Muzeun e Mbretit Nikolla, Muzeun Etnografik dhe Muzeun e Artit në Cetinë.



» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



European Integration Office



Ministry of finance  
Directorate for Finance and Contracting  
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Pushtetit Lokal  
Ministarstvo lokalne samouprave  
Ministry of Local Government



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA  
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**  
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi  
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

**Sanja TODOROVIC**

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik  
E-mail: [sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Maja RADOVIC**

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat  
E-mail: [maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Nikola DJONOVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Almir CAUSEVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Petar BELADA**

Asistent Administrativ  
E-mail: [petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**  
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri  
Telefon: + 355 22 80 20 80;

**Andi ÇEKAJ**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**

Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë, Kosovë

**Gazmir RACI**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org)

[www.cbc-mne-alb.org](http://www.cbc-mne-alb.org) | [www.cbc-mne-kos.org](http://www.cbc-mne-kos.org)



Ky projekt është i financuar  
nga Bashkimi Evropian